


Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehures Drita Curri nga Hani Elezit , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 19.11.2013 merr këtë;

A K T V E N D I M

E pandehura Drita (Zyber) Curri ,e lindur me dt.13.03.1983 ne Shkup ,me vendbanim ne Han te Elezit , shqiptare, shtetase e Republikes se Kosoves, e pa martuar ,ka te kryer fakultetin , keshilltare komunale ne Asamblene komunale ne Han te Elezit ,e gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gj e gj ë s e



Sepse si zyrtare e larte publike ne pozitën e keshilltares komunale ne Asamblene Komunale ne Han te Elezit ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me daten 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'i zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'i llogariten nga 15 (Njëzet) €

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Arsyetim

Agjensia Kunder Korrupsionit ne Prishtine , ka parshtruar kërkesen per fillimin e procedures kundervajtese nr.01-2348/12 te dates 02.07.2012 , kunder te pandehures Drita Curri nga Hani Elezit ,per kundervajtje nga neni 5 ,6 dhe 9 i sansksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare, dhe ka kerkuar qe e njejta te shpallet fajtores dhe te denohet sipas ligjit.

Ne baze te kerkeses se parashtruar e pandehura eshte marre ne pyetje nga ana e gjykates me te cilin rast ka deklaruar se formulari i saj per deklarimin e pasurise i plotesuar eshte derguar ne AKK Prishtine me date 17.08.2012 sepse sipas saj eshte neglizhuar dorezimi I formularit ne afatin e percaktuar me ligj , nga ana e punetorit te kuvendit komunal ,por qe nuk ka patur per qellim qe t'i ik obligimit ligjor te deklarimit te pasurise .

Per vertetimin e plote te gjendjes faktike gjyqtarja ftoi ne cilesi te deshmitarit zyrtarin komunal Driton Kaloshi ,I cili ne pyetjen e gjyqtares deklaroi se ,ka qene pike kontaktuese per Agjensine Kunder Korrupsionit ne komunen e Hani Elezit deri kah fundi I vitit 2011,mirepo ne shkurt te vitit 2012 pranon se I ka dorezuar agjensise listen me emrat e zyrtareve te larte komunale te komunes se Hanit te Elezit cilet sipas ligjit kane qene te detyruar qe ta deklarojne pasurine ,mirepo shton se keta zyrtare te larte te perfshire ne liste nuk I ka informuar per obligimin e deklarimit te pasurise duke vleresuar se kete eshta dashur t'a beje kryesuesi I kuvendit Mendu Vlasi dhe zyrtari komunal Kujtim Dernjani.

Per t'u deklaruar rreth kualifikimit juridik te kundervajtjes ,gjyqtarja ftoi edhe perfagesuesin e AKK,se ,ku me ate rast perfagesuesi me autorizim I AKK,se Enis Sadiku deklaroi se, mbetet ne teresi prane kualifikimit juridik te kundervajtjes ,pasi qe sipas tij e pandehura asnjehere me pare nuk e ka deklaruar pasurine e saj prane AKK,se ,gjersa ka qene ne poziten e keshilltares komunale ,pasi qe kuptohet se edhe ligjerisht nuk ka patur obligim,e qe per kete arsye sipas tij nuk mund te konsiderohet se kemi te bejme me deklarimin e rregullt vjetor por me deklarimin sipas kerkeses se Agjensise .

Per vertetim me te plote te gjendjes faktike gjyqtarja ka ftuar ne cilesi te deshmitarit Mendu Vlasi ,kryesues I Kuvendit Komunal Hani Elezit ,I cili ne fjalen e tij deklaroi se :keshilltarja komunale Drita Curri ka qene e njoftuar per obligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,se ne Prishtine nga ana e tij por edhe nga ana e sekretarit te Kuvendit te komunes se Hanit te Elezit,para dates 31.03.2012 dhe per ta vertetuar deklaraten e tij ka prezentuar para gjykates listen e nenshkrimeve te anetareve te kuvendit te komunes per seancen e rregullt te dates 23.02.2012, ne te cilen deklaroi se te gjithë keta anetare jane njoftuar per obligimin e deklarimit te pasurise dhe njeherit prezenton edhe kopjen e e-mailit te sekretarit te kuvendit te komunes Avni Bushi te dates 15.03.2012,nga I cili shihet se keshilltarja komunale Drita Curri me daten 15.03.2012 ka qene e njoftuar permes e-mailit te saj per obligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,ne Prishtine.

Gjyqtarja mori ne pyetje edhe zyrtarin komunal Kujtim Dernjani I cili ne fjalen e tij deklaroi se qe nga data 12.03.2012 me nje vendim te kryetarit te komunes se Hani Elezit ,I jane caktuar edhe detyra shtese ,perveq punes qe e ben si zyrtar I sherbimeve publike ,gjegjesisht I eshte caktuar qe te shebeje edhe si zyrtar per antikorrupsion ,per te drejta e njeriut dhe pranim te

dhuratave .Me tutje shton se nuk I ka njoftuar keshilltaret komunale per obligimin e deklarimit te pasurise duke perfshire edhe keshilltaren Drita Curri ,pasi qe njoftimi eshte dashur te behet nga zyrtari paraprak Driton Kaloshi pasi qe I njeiti edhe e ka derguar listen e zyrtareve komunal te Hani Elezit te cilet kane patur obligim deklarimin e pasurise ,prane Agjensise kunder korrupsionit .

Deshmitari Fahri Kalisi ne pyetjen e gjyqtares deklaroi se keshilltarja komunale Drita Curri ,formularin e plotesuar per deklarimin e pasurise I'a ka dorezuar pas kalimit te afatit ligjor per deklarimin e pasurise ,gjegjesisht pas dates 31.03.2012 ,dhe shton se I kujtohet qe edhe vete kjo keshilltare e ka pranuar se e ka neglizhuar obligimin e deklarimit te pasurise .Me tutje shton se formularin e pranuar nga keshilltarja komunale Drita Curri se bashku me zyratin komunal Kujtim Dernjani e ka dorezuar ne Agjensine kunder korrupsionit ,pasi qe sipas tij agjensia kishte kerkuar nga deshmitari qe edhpse me vonese keshilltaret qe nuk e kishin deklaruar pasurine deri ne ate kohe ,t'I sjellin formularet e plotesuar per deklarimin e pasurise.

Në bazë të dhënave si në kërkesë , deklaratës së të pandehures ,deklaratës se perfaqesuesit me autorizim te AKK,se ne Prishtine Enis Sadiku ,deklaratave te deshmitareve Driton Kaloshi,Mendu Vlashi ,Kujtim Dernjani dhe Fahri Kalisi ,njoftimit te dates 15.03.2012 dhe shkresave tjera te lendes , gjyqtarja konstatoi se në veprimet e të pandehures ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par.1 nenpar.1.1 pasi qe me Ligjin nr.04/L-050 te gjithe keshilltaret komunale te Asambleve komunale jane perfshire ne listen e zyrtareve te larte qe njeherit edhe kane obligim deklarimin e rregullt vjetor prane AKK,se ne Prishtine,dhe per mandatin sa jane ne kete pozite kane per obligim deklarimin e rregullt vjetor te pasurise se tyre, dhe rrjedhimisht obligimi I deklarimit te pasurise del sipas ligjit, edhe nese agjensioni nuk kerkon deklarimin e pasurise.

Andaj gjykata duke u bazuar ne te theksuarat me larte ka bere rikualifikimin juridik te kundervajtjes dhe te pandehuren conform nenit 17 par.1 nenpar.1 e shpalli përgjegjëse dhe e dënoi me denim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , te cilin eshte e obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten conform nenit 5 te LK,se dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burg do t'I llogariten nga 15 (pesembedhete) € .

Gjykata me aplikimin e nenit 9 par.1 pika 1 te pandehures I ka shqiptuar denim me gjobe nen masen minimale te denimit te percaktuar per kete kundervajtje,pasi qe e pandehura I ka evituar pasojat e kesaj vepre kundervajtjese duke e deklaruar pasurine e saj prane AKK,se me date 17.08.2012.

Me rastin e marrjes së aktvendimit konform nenit 7 të Ligjit për Kundërvajtje ,Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese,kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se e pandehura e ka permbushur obligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,se ne Prishtine dhe se ka qene hera e pare qe e njeita ne poziten e keshillaters komunale ka patur obligim ligjor deklarimin e pasurise prane AKK,se ne Prishtine ,ndersa rrethanë të posaqme rënduese gjykata nuk gjeti pos veprimeve të të pandehures të cilat paraqesin elementet e veprës kundërvajtëse për të cilin është shpallur përgjegjës dhe eshte denuar si ne dispozitiv , duke vlerësuar se edhe me një denim të tillë do të arrihet efekti I sanksionimit ashtu që në të ardhmën e pandehura t'u shmanget kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme kundërvajtëse.


Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 109 të Ligjit për Kundervajtje me të cilin rast gjykata e detyroi të pandehuren që kësaj gjykate t'i përmbush shpenzimet e procedurës në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 05.00 € duke pasur parasysh nderlikueshmerine e procedurës, gjendjen materiale të pandehures, me bindjen se edhe një denim i tillë nuk do të ndikojë dukshëm në buxhetin familjar të pandehures.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
DEGA NE KAÇANIK**

R.I.nr.2130/2012 date 19.11.2013

Sekretarja juridike,
Indira Beqa



Gjyqtarja,
Zefire Muhaxheri



Keshilla juridike: Kunder këtij Aktvendimi i pandehuri
Dhe parashtruesi i kërkesës mund të paraqesin ankese
në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimimit në
Gjykatën E apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate